



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nënk. Org. Org. Jedisice Org. Unit:	SP-02
Nënk. Prot. Org. Protok. Prot. No:	3045-2/26
Nr. i fletës Fletës shprehës No pages:	04
Tamën. Drejtimit Data:	23.07.26
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.07.2026
REFERENC-Ë:	26/3045/MMPH
PËR/ZA/TO:	"EV WIND PARK" SH.P.K. Prishtinë Parku i energjisë me erë "Zatriqi 1" me kapacitet 35 MW në Zatriq- Rahovec
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për aprovim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "EV WIND PARK" SH.P.K. Prishtinë, me nr. 26/3045/MMPH.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në teren, mbajtjes së debatit publik me qytetar, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "EV WIND PARK" SH.P.K. Prishtinë, për Parkun e energjisë me erë "Zatriqi 1" me kapacitet 35 MW në Zatriq- Rahovec; dhe
2. Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/3045/MMPH
Datë: 23.07.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit për Pëlqim Mjedisor Nr.1249-2/26, dt. 23.06.2026, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore dt. 23.07.2026, nxjerr këtë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "EV WIND PARK" SH.P.K. Prishtinë, pajiset me Leje Mjedisore për Parkun e energjisë me erë "Zatriqi 1" për 6 turbina me kapacitet të përgjithshëm 35 MW në ngastrat kadastrale P- 71510031-00530-1, nr. P- 71510031-00754-0, nr. P- 71510031-01304-2 në Zatriq-Rahovec.

2. Operatori obligohet:

- Të zhvillojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në këtë leje;
- Të kryejë matje të nivelit të zhurmës së gjeneruar nga funksionimi i turbinave me erë në pikat më të afërta të ndjeshme, përkatësisht afër zonave të banuara;



- Të hartojë dhe dorëzojë në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit raport vjetor për rezultatet e matjeve të zhurmës, duke dëshmuar respektimin e vlerave kufitare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Të respektojë kërkesat për mbrojtjen e shpendëve në përputhje me Direktivën e Shpendëve;
- Të kryejë monitorim të vazhdueshëm të ndikimit të turbinave në avi-faunë (shpendë dhe lakuriqët e natës);
- Të hartojë dhe dorëzojë në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit raport vjetor mbi rezultatet e monitorimit të avi- faunës, duke përfshirë rastet e mortalitetit, ndikimet e konstatuara dhe masat e ndërmarra për zbutjen e tyre;
- Në rast të regjistrimit të incidenteve me shpendë ose lakuriqë nate, të zbatojë pa vonesë masat zbutëse, deri në ndalimin e përkohshëm të turbinave gjatë periudhave të migrimit ose periudhave të tjera kritike, sipas rekomandimeve të ekspertëve;
- Të mirëmbajë në mënyrë të rregullt turbinat me erë dhe infrastrukturën tjetër përcjellëse;
- Për procesin e operimit të zbatojë të gjitha masat e përcaktuara në vendimin e pëlqimit mjedisor;
- Të raportojë në MMPH për çdo aksident, avari ose incident që mund të ketë ndikim në sigurinë publike ose në mjedis, pa vonesë ne afatin sa me të shkurt kohorë;
- Të zbatojë masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, si dhe të mbajë plan emergjent për reagim në raste aksidentesh;
- Të zbatojë planin dinamik të rehabilitimit të përshkruar në informatat shtese.
- Në rast të ndërprerjes së përhershme të aktivitetit, të çmontojë objektet dhe pajisjet, të menaxhojë mbetjet sipas legjislacionit në fuqi dhe të rehabilitojë zonën e ndikuar.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore vizitës në terren për verifikimin e kushteve mjedisore për operatorin "EV WIND PARK" SH.P.K. Prishtinë, është konstatuar se operatori për veprimtarinë: Parkun e energjisë me erë "Zatriqi 1" për 6 turbinat me kapacitet të përgjithshëm 35 MW, në ngastrat kadastrale: nr. P- 71510031-00530-1, nr. P- 71510031-00754-0, nr. P- 71510031-01304-2, në Zatriq- Rahovec, plotëson kriteret e parapara me Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 04/2022.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.



Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Rahovecit;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.